



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI I ANKIMIMEVE DHE
SANKSIONEVE

Data: 28 Maj 2021

Nr: 92

VENDIMI

“PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 53 TË KANDIDATIT TË
MBËSHTETUR NGA ZGJEDHËSIT, ILJAZ SHEHU”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 28.05.2021, me pjesëmarrjen e:

Koli BELE	-	Kryesues
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Elvin LAKO	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Në prani të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm,

Shqyrtoi çështjen me:

Ankues : Iljaz Shehu, kandidat i mbështetur nga zgjedhësit në qarkun Lezhë;

OBJEKTI:

- 1- Kundërshtimi i Vendimit Nr. 349, datë 04.05.2021 “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për Rezultatit në zonën zgjedhore Qarku Lezhë, për subjektet zgjedhore dhe për kandidatët për deputet, në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”
- 2- Pavlefshmëria e zgjedhjeve të zhvilluara në datën 25.04.2021 në zonën zgjedhore Qarku Lezhë;



BAZË LIGJORE: Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “b”, 124, 133, 142, 160 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe shkronja “a”, e pikës 1, të nenit 30, të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020 të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e rregullores “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”

Rrethanat e çështjes:

1. Z. Iljaz Shehu, kandidat i mbështetur nga zgjedhësit për qarkun Lezhë ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 53 regj., datë 10.05.2021.
2. Në kërkesën e tij ankimore, z. Shehu kundërshtonte vendimin nr. 349, datë 04.05.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e Tabelës Përmbledhëse për rezultatin e votimit në zonën zgjedhore Qarku Lezhë, për subjektet zgjedhore dhe kandidatët për deputetë në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021” dhe kërkonte shpalljen e pavlefshmërisë së zgjedhjeve në zonën zgjedhore qarku Lezhë.
3. Në mbledhjen e datës 11.05.2021, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) vendosi kalimin për shqyrtim të kësaj kërkesë. Seanca për shqyrtimin e kërkesës ankimore u zhvillua në datën 28.05.2021. Subjekti ankues ka marrë dijeni për ditën e zhvillimit të seancës nëpërmjet njoftimit publik në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, si dhe nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike nga administrata e KQZ-së.

Pas çeljes së seancës, u konstatua se subjekti ankues, në rrugë elektronike ka shprehur vullnetin e tij për të mos ndjekur ankesën e tij pranë Komisionit, duke hequr kështu dorë nga objekti i ankimit sipas nenit 142 të Kodit Zgjedhor. Referuar kësaj norme, *KQZ-ja vendos pushimin e çështjes në tërësi ose për pjesën që është hequr dorë. Pas kësaj ankuesi nuk mund të paraqesë përsëri ankimin, për të cilin është vendosur pushimi i çështjes.*

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në analizën e fakteve dhe provave të administruara, mbështetur në shkronjën “a” të pikës 1, të nenit 30, të vendimit nr. 3, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, KAS,



V E N D O S I:

1. Pushimin e shqyrtimit të kërkesës ankimore nr. 53 të paraqitur nga kandidati i mbështetur nga zgjedhësit z. Iljaz Shehu.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë brenda 5 ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

Koli **BELE** - **Kryesues**

Elvis **ÇEFA** - **Anëtar**

Elvin **LAKO** - **Anëtar**

Ledio **BRAHO** - **Anëtar**